



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. ___prot.

Roskovec, më _____.____.2021

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE
PËR POZICIONIN**

“KRYEINSPEKTOR I INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES SË TERITORIT”

BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 64 , gërma “g” ; në Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Bashkisë Roskovec si dhe Njësive Administrative në varësi Kuman, Strum, Kurjan” si dhe në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.102 date 24.12.2020 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, për vitin 2021”, ligj nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, Ligjit nr.9780, datë 16.7.2014 “Për inspektimin edhe mbrojtjen e territorit nga ndertimet e paligjshme” ,

Bashkia Roskovec shpall vendin e lirë të punës “Kryeinspektor I Inspektoriatit të Mbrojtjes së Teritorit”,

Afati I fundit I paraqitjes së aplikantëve është më datë _____.____.2021

Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të “Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Teritorit” janë,

1. Të organizojë dhe drejtojë të gjithë veprimtarinë e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Teritorit në Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative, për të cilën raporton tek Drejtori i IMT-së dhe Policisë Bashkiake”
2. Nënshkruan aktet që dalin nga IMT-ja dhe kërkon nga vartësit ndjekjen për zbatimin e tyre;
3. Ndjek zbatimin e detyrave që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore në vep-rimtarinë e IMT-së;
4. Shqyrton dhe merr vendime për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit;
5. Vendos masa administrative në ngarkim të subjekteve që shkelin ligjshmërinë në fushën e ndërtimit, siç parashikohet në aktet ligjore në fuqi
6. Vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimit ligjor.

7. Përgatit kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
8. Vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
9. Në zbatim të detyrimeve ligjore kërkon zyrtarisht mbështetjen e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, për zbatimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundraligjshme;
10. Jep informacion në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati
11. Kërkon për verifikim nga arkivi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dokumentacionin mbi subjektet e ndërtimit që janë në procedura verifikimi për shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit.

B. Kriteret e punësimit të “Kryeinspektor I Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit” janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë diplomë Master Shkencor në fushat e drejtësisë dhe ë fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”,
- Ligjit, nr.10433, date 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjit nr.9780, datë 16.7.2014 “Për inspektimin edhe mbrojtjen e territorit nga ndertimet e paligjshme”

C. Dokumentat që duhet të dorëzojnë të interesuarit, janë si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim,
- Curriculum Vitae,
- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe listës së notave ;
- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- Vërtetim për eksperiencën e mëparshme të punës.

Konceptoi:*O.Brahushi*

Miratoi:*D.Hoxha*

Konfirmoi:*E.Gishto*

Sasia e ekzemplarëve të shtypur 3 (tre)

KRYETAR

Majlinda Bufi